



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 4.10.2023

Nr: 787

Ora: 12:30

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN
VETËDEKLARUES Z. QERIM ISMAIL ISMAILAJ, KRYETAR I BASHKISË MALLAKASTËR, QARKU
FIER, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE"**

Sot më datë 4.10.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues Z. Qerim Ismail Ismailaj, Kryetar i Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier, i propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Palë të Interesuara: Z. Qerim Ismail Ismailaj, Kryetar i Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier, i propozuar nga "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Baza Ligjore: Nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenet 90 dhe 95, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative", i ndryshuar, ligji nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Data: 4.10.2023 Nr: 787
Ora: 12:30



"Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Qerim Ismail Ismailaj, Kryetar i Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier, i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë".

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

I.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte, ndër të cilat është dhe "Kryetari i Bashkisë".

Në zbatim të këtyre dispozitave, z. Qerim Ismail Ismailaj, kandidat për Kryetar për Bashkinë Mallakastër, më datë 31.3.2023, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr unik FR-PS-16657. KQZ bëri verifikimin "*prima facie*" dhe pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtme:

Për këtë kandidat, në datën 1.4.2023, pranë KQZ është depozituar formulari i vetëdeklarimit, i cili është regjistruar me nr. unik FR-PS-16657.

Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, KQZ ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB).

Në përgjigje të kësaj kërkesë të KQZ, DPB informon se kandidati në fjalë nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Qerim Ismail Ismailaj.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Qerim Ismail Ismailaj, rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën I. "TË DHËNA PERSONALE", PIKA B, "Gjeneralitete të mëparshme" të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se nuk ka ndryshim në gjeneralitetet e tij.
- Në rubrikën III. "TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT", të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 1 "A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë", subjekti vetëdeklarues është përgjigjur "PO",

- Pyetjes 3 “A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoriteti i huaj, për kryerjen e një veprë penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”,

Nga konstatimet e mësipërme dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 4096 prot., datë 24.4.2023, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 605/27 prot., datë 20.9.2023, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Qerim Ismail Ismailaj. Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatit e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Qerim Ismail Ismailaj, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Nuk rezulton të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile;
- Rezulton të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga:
 - Gjykata e përbërë nën Betim të Chios, me vendim nr. 9-11/2000, me 3 (tre) vite burgim për veprën penale të “Konfliktit”/ “Përleshjes”, parashikuar nga neni 313, i Kodit Penal të Republikës së Greqisë, që i korrespondon veprës penale të “dëmtime të tjera me dashje”-parashikuar nga neni 90/1, i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, e cila si sanksion parashikon vetëm dënimin me gjobë;
 - Gjykata e posaçme e shkallës së parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 11, datë 2.2.2023, për veprën penale “Falsifikimi i vulave i stampave ose i formularëve”, parashikuar nga neni 190, paragrafi i parë, i Kodit Penal, me 4 (katër) muaj burgim, të pezulluar ekzekutimin e tij, dhe detyrimin për kryerjen e një pune me interes publik, pa shpërblim, për një kohë prej 40 (dyzet) orësh, brenda një afati 6 muajsh.
- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jo përfundimtar nga një autoritet gjyqësor për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Rezulton të ketë qenë në hetim/gjykim, për kryerjen e veprës penale të:
 - “Konfliktit”/ “Përleshjes, parashikuar nga neni 313, i Kodit Penal të Republikës së Greqisë, për të cilin është dënuar me 3 (tre) vite burgim nga Gjykata e Përbërë nën Betim të Chios, me vendimin nr. 9-11/2000;
 - “Falsifikimit të Formularëve” parashikuar nga neni 190, paragrafi i parë, i Kodit Penal, në kuadër të procedimit penal nr. 236, të regjistruar më datë 7.9.2021, nga Prokuroria

e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar, e cila, e ka dërguar për gjykim, më datë 1.11.2021, në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar, e cila, me vendimin nr. 11, datë 2.2.2023, e ka dënuar me 4 (katër) muaj burgim, të pezulluar ekzekutimin e tij, dhe detyrimin për kryerjen e një pune me interes publik, pa shpërblim, për një kohë prej 40 (dyzet) orësh, brenda një afati 6 muajsh.

- Nuk rezulton të ketë qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale;
- Nuk rezulton ti jetë caktuar masë shtrënguese e sigurisë personale;
- Nuk rezulton të jetë lëshuar ndonjëherë ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale;
- Nuk rezulton të jetë jetë marrë për të masa e dëbimit nga një shtet i huaj, në lidhje me një prej rasteve të parashikuara në pikën 1, shkronja “a”, “b” dhe “c” të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015, apo për cenim me shumë rëndësi serioze, të sigurisë publike;
- Nuk rezulton të ketë të tjera indicie apo të dhëna, a rrethana, fakte të bëra publike, apo informacion, me qëllim verifikimi të mëtejshëm:
 - për veprimtari kriminale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - për qenien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj;
 - për urdhër kërkimi ndërkombëtar, lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
 - dëbime nga territori i ndonjë shteti, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - përdorimin e të dhënave personale/gjeneraliteteve të tjera.

III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të administruar gjatë procesit të regjistrimit të kandidatit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se:

Ligji nr. 138/2015 dhe vendimi i Kuvendit, nr. 17/2016 përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar se subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me gjeneralitetet e tyre aktuale e të mëparshme, rekordet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (vendime dënimi përfundimtare ose jo, hetime penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, masa sigurimi personale, vendime dëbimi, ndalime, arrestime, hetime, etj).

Për sa më sipër, subjekti vetë deklarues, z. Qerim Ismail Ismailaj, Kryetar i Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016. Referuar të dhënave të disponuara, kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/ moszgjedhshmërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Konstatimin se z. Qerim Ismail Ismailaj, Kryetar i Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI